

PYETJE DHE PËRGJIGJE PËR APLIKANTËT E GRANTEVE TË VOGLA PËR BUNËN

1. Kush mund të aplikojë?

Të gjithë individët, OJQ-të, OSHC-të, Universitetet, Shkollat me vendodhje brenda kufijve të Peizazhit të Mbrojtur të Lumit Buna-Velipojë kanë të drejtë të aplikojnë. Vetëm organizatat të cilët gjenden jashtë zonës PMLBV, kanë gjithashtu të drejtë të aplikojnë, por vetëm nëse ata tregojnë se kanë eksperiencë në zbatimin e disa projekteve në Bunë dhe do të përfshijnë lokalët gjatë procesit zbatues.

2. Cilat njësi konsiderohen të pranueshme për të formuar një koalicion?

Vetëm organizatat mund të formojnë koalicione, jo individët.

3. Si mund të aplikoj?

Duhet të lexoni me kujdes udhëzuesit dhe të plotësoni formularin e aplikimit. Ju mund të shkarkoni udhëzuesit dhe formularin e aplikimit [këtu](#). Jeni të mirëpritur të dërgoni aplikimin tuaj në e-mail: info@inca-al.org ose ta dorëzoni aplikimin në formën e kopjeve të shtypura në ambientet e Administratës së Zonave të Mbrojtura Shkodër.

4. Cilat tipe të projekteve mund të zbatoj?

Projektet që mund të zbatohen duhet të kenë të bëjnë me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, peshkimin e qëndrueshëm, bujqësinë e qëndrueshme dhe restaurimin e habitateve. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni udhëzuesit dhe shembujt e dhënë.

5. Cila është data e fundit e pranimit të projekt propozimeve?

Thirrja do të jetë e hapur deri në datën 23 Shtator 2019, ora 14:30.

6. A më nevojitet një llogari bankare?

Po, aplikanti duhet të ketë një llogari bankare në mënyrë që të marrë pagesat për projektin. Nuk do të bëhen pagesa në lek dore. Të gjitha transfertat bankare do të bëhen në Euro.

7. Sa është shuma maksimale që mund të përfitohet për secalin grant?

Për propozimet e individëve – 5,000.00 EUR

Për organizatat/njësitë ligjore/operatorët e bizneseve – 10,000.00 EUR

Për partneritetet mes disa organizatave – 20,000.00 EUR (në rast se projekti mbulon dy tematika prioritare – 20,000.00 EUR; 3 tematike prioritare – 30,000.00 EUR; 4 tematike prioritare – 40,000.00 EUR)

Projektet që lidhen me restaurimin e habitateve bregdetare – 30,000.00 EUR

8. Sa është kohëzgjatja e projektit?

Projekti duhet të zbatohet në periudhën Tetor 2019 – 1 Qershor 2020.

9. Ku duhet të zbatohet projekti?

Projekti duhet të zbatohet në Peizazhin e Mbrojtur të Lumit Buna-Velipojë. Ju lutem, shikoni **hartën**

10. Kur do ta kuptoj që projekti im është përzgjedhur?

3 javë pas mbylljes së aplikimeve, në datën 15 Tetor 2019.

11. Kush do ta vlerësojë projekt propozimin tim?

Bordi i vlerësimit konsiston në partnerët e projektit - IUCN, INCA, PAP/RAC, GEP-MED, TdV si dhe përfaqësues nga AdZM Shkodër dhe Bashkia Shkodër.

12. Cila do të jetë skema e pagesës (shpërndarjes së grantit)?

40% e grantit do të jepet në fillim të zbatimit të projektit dhe 60% në përfundim të projektit.

13. A mund të ketë tre skema të pagesës për projektet e mëdha të OJQ-ve?

Një pagesë e ndërmjetme është e mundur për projektet e mëdha mbi 10,000.00 EUR për OJQ; për shembull: skema 30% - 30% - 40% dhe kjo kërkesë duhet të mbështetet me justifikimin përkatës.

14. A duhet të dorëzoj një raport që përshkruan ecurinë e projektit?

Draft modeli i raportit do t'i shpërndahet çdo aplikati fitues. Fituesit/fituesve do t'u kërkohej të japin një ose dy raporte afat-mesme në varësi të kohëzgjatjes së projektit.

15. Përse granti nuk mundëson projekte më të mëdha mbi tavanin e vendosur?

Qëllimi i Programit të Granteve të Vogla është të kontribuojë në restaurimin e habitateve dhe ekosistemeve të PMLBV përmes zhvillimit të iniciativave të vogla në shkallë lokale dhe në të njëjtën kohë mbështet përmirësimin e situatës socio-ekonomike të komuniteteve lokale që jetojnë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore të zonës target.